VENDIM
Nr. 740, datë 2.10.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PASTRIMI I KOLEKTORIT NGA RRUGA 'DEMOKRACIA' DERI TEK RRUGA 'VASIL PUKA', BASHKIA VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Pastrimi i kolektorit nga rruga 'Demokracia' deri tek rruga 'Vasil Puka', Bashkia Vlorë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 1 732 845 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 732 845 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vlorë.
8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.
10. Bashkia Vlorë, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, e cila, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE, SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PASTRIMI I KOLEKTORIT NGA RRUGA 'DEMOKRACIA' DERI TEK RRUGA 'VASIL PUKA', BASHKIA VLORË"

Pronarët		**Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)**								**Vlerësimet për shpronësim**						**Vlera totale (lekë)**	**Shënime**
										Truall			**Ndërtesë**				
Nr.	**Emër/Mbiemër**	**ZK**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sipërfaqja totale (m²)**	**Truall (m²)**	**Ndërtesë (m²)**	**Volum**	**Faqe**	**Sipërfaqja e shpronësuar (m²)**	**Çmimi (lekë/m²)**	**Vlera (lekë)**	**Sipërfaqja e shpronësuar (m²)**	**Çmimi (lekë/m²)**	**Vlera (lekë)**		
1	Fatmira Canaj (Fataj) Kimet Fataj Gezime Koço (Fataj) Servet Fataj Petrit Fataj Hava Fataj Qerem Fataj	8605	37/118	Truall dhe ndërtesë	35	35	35	18	133	1	8300	8,300	35	32,625.29	1,141,885	1,150,185	
2	Artur Dhamo	8605	38/32	Truall	219	219	0	11	9	24.3	8300	201,690	0	0	-	201,690	
3	Hysen Bimo Kadri Bimo	8605	38/6	Truall	120	120	0	14	142	45.9	8300	380,970	0	0	-	380,970	
VLERA TOTALE																**1,732,845**	